

Luan TETAJ

PROJEKTET E MARK GJINIT PËR ÇLIRIMIN E SHQIPËRISË (1596-1607)

Kapedan Mark Gjini,¹ ishte njëri ndër figurat më të shquara shqiptare të luftës kundër Perandorisë Osmane në fund të shek. XVI dhe në fillim të shek. XVII. Ai rrjedh nga një familje e shquar patriotike shqiptare më përvojë ushtarake në luftë kundër sunduesve të huaj në trevat shqiptare. Shqiptarët ishin në kryengritje të vazhdueshme, veçanërisht fiset e Shqipërisë Veriore. Gjatë asaj kohe u mbajtën takime dhe kuvende, për t'u organizuar sa më mirë për luftë, dhe për të sensibilizuar edhe shtetet evropiane, që të mbështesin luftën e shqiptarëve kundër pushtuesve shekullorë osmanë.

Familja Gjini krahas familjeve tjera mesjetare shqiptare, jetonte në "Shqipërinë Venedikase", e cila luajti një rol kryesor në historinë shoqërore dhe ushtarake në bregdetin lindor të Adriatikut.² Familja Gjini përmendet për herë të parë në vitin 1216 në një letër dërguar nga Papa Inoçenti III, drejtuar Dhimitër Gjini, princit të Shqipërisë.³ Stërgjyshi i Mark Gjinit në ushtrinë e Skënderbeut kishte qenë flamurmbajtës, i cili ishte vrarë gjatë ekspeditës ushtarake në Pulje, më 1461. Ndërsa i ati i tij kishte kryesuar delegacionin e kryengritësve shqiptarë pranë shtabit të komandantëve të flotës së koalicionit të Lepantit në vitin 1571.⁴

¹ Mark Gjini mbante titullin kapiten i Stradiotit që i shërbente Republikës së Venecias. Ai dha kontribut të madh për venecianët në Luftën e Uskokëve, nën udhëheqjen e gjashtë anije dhe rreth 300 shqiptarë. Ka të dhëna të pakta dhe të besueshme që flasin drejtpërdrejt për origjinën dhe familjen Gjini, si dhe të avokatëve të tyre të periudhave të mëhershme. Nga të dhënat që lidhen më anëtarët e familjes Gjini, që ishin aktivë në shërbimin ushtarak venecian në XVI dhe XVII, është pakës e vështirë të përcaktojmë saktësisht se në cilën pjesë të Shqipërisë mund të kërkojmë origjinën.

² Lovorka Coralić, "Albanska obitelj Ginni u povijesti Dalmacije i Istre (XVI. i XVII. st.) – prilog poznavanju komunikacija duž istočno jadranske obale", *Izvorni znanstveni rad Primljeno*: 21. svibnja 2007, Prihvaćeno za tisak: 3. prosinca 2007, Zagreb, 272

³ Mary Edith Durham, *Some Tribal Origins, Laws and Customs of the Balkans*, George Allen & Unwin, 1928, Original from the University of Michigan Digitized Oct 7, 2008, 65.

⁴ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nr. 1, Tiranë, 2008,

Mark Gjini, punonte në shërbimin napolitan. Ai u përkiste atyre drejtuesve ushtarakë shqiptarë që shërbente në ushtrinë italiane. Fillimisht ai ishte “Gouvernador de la Milicia Albanese” në Republikën e Venecias, e më pastaj u transferua në Napoli, ku gjithashtu komandoj trupat shqiptare. Të tre vëllezërit e tij gjithashtu ishin aktivë në ushtrinë spanjolle. Ai ishte i përfshirë në organizimin e fillimit të kryengritjeve në Shqipëri. Që nga fillimi i 1595 mbante lidhje të vazhdueshme dhe të forta me vendin e tij.⁵

Më 12 tetor 1595, proveditori i Kotorrit kishte marrë urdhrin që me anije, të shoqëruar me një roje të besueshëm peshkopin e Korçulës, Tomë Plezhën dhe Mark Gjinin, t’i dërgonte në Venedik. Senati diskutonte propozimet dhe mundësinë që të angazhohej në çështjen e shqiptarëve. Gjatë diskutimeve u tha se do të ishte më mirë që Shqipëria dhe bregu lindor i Adriatikut të kalonte nën zotërimin e krishterëve se sa të mbetej nën sundimin e Perandorisë Osmane.⁶ Po atë vit Kapedan Marko Gjini, është regjistruar si komandant i një njësie të tillë detare, në lidhje me projektet e vendeve të krishtera për të çliruar Tivarin, Ulqinin dhe Shkodrën.⁷

Më 13 tetor të vitit 1595, në Romë kishte vajtur Mark Gjini, i cili paraqiti letrat-projektet kardinalit P. Aldobrandinit.⁸ Kërkoj nga ipeshkvi që ta njoftonte “për kohën kur mund të organizohej ndonjë aksion”. Por, nuk duhej të nxitoheshin për t’i filluar aksionet ushtarake, se mund të venin në rrezik të krishterët pa qenë e nevojshme. Më e mira do ishte që të gjendej ndonjë mundësi që t’u shkaktonte dëme ushtrisë osmane dhe të shihej “*se mos gjendej ndonjë person i guximshëm, që ishte i gatshëm të sulmonte me njerëzit e tij ndonjë nga kështjellat e atyshme*”. “Kuria një mundësi të tillë nuk do ta pengonte, por do ta përkrahte brenda mundësive të saj. Megjithatë, duhej treguar kujdes për të shmangur çdo ekspozim të panevojshëm dhe emri i papës të mos lakohej në këtë rast e çdo gjë duhej të mbahej sekret.”⁹

842.

⁵ Peter Bartl, *Die Albaneser Versammlung von Dukagjin im Jahre 1608*, Beiträge zur Südosteuropa - Forschung anlässlich des I. Internationalen Balkanologen kongresses in Athen, München, 7. V.-13. V. 1970, 13.

⁶ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. II (1593-1602) dok. (34): “1595 tetor 9, Kotorr - Procesverbali për një njeri që merret në pyetje në lidhje me bisedimet e marrëveshjes që janë duke u bërë për organizimin e kryengritjes në Shqipëri”, 50-51.

⁷ Čoralić, “Albanska obitelj Ginji”, 275.

⁸ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. II (1593-1602) dok. (37): “1595 tetor 12-Autori i Nikolo Donatos, flet për bisedime që bëheshin prej të fuqishmeve të Evropës për një marrëveshje me krerët shqiptarë për të pushtuar Ulqinin e Shkodrën”, 62.

⁹ Bartl, Peter, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane*,

Me një fjalë u mundua të hiqte dorë nga veprimet politike, dhe shqiptarët të prisnin momentin më të volitshëm.

Më 14 tetor të vitit 1595, Senati venedikas urdhëroi provedidorin e Kotorrit që t'i jap gjithë ndihmën e nevojshme proveditorit të flotës, që ky të mund të arrestonte krerët shqiptarë, Tomë Plezhën, Mark Gjnin dhe peshkopin, në mënyrë që të bëhej marrëveshje për kryengritjen e armatosur, dhe pastaj të dërgoheshin në Venedik.¹⁰ Më 18 tetor të atij viti, Senati e lavdëroi provedidorin e Kotorrit për çështjen e arrestimit të krerëve shqiptarë. E uruan për informatat që kishin dërguar dhe porositi informatorin të vazhdonte t'i bindë krerët shqiptarë për ta shtyrë për një kohë më të përshtatshme kryengritjen e armatosur.¹¹ Më 2 dhjetor të vitit 1595, urdhri për arrestimin e Tomë Plezhën, Mark Gjnin ishte përmbushur. Situata në Shqipëri kishte filluar të qetësohej, Venediku e shihte se çështja e kryengritjes nuk ishte aq afër siç ishte menduar në fillim. Kjo vërehej nga korrespondencat e Romës, sepse Papa dhe princat e tjerë nuk po vepronin siç kishin premtuar në fillim. Senati porositi qeveritarin e Kotorrit që të hiqej arrestimi i peshkopit nëpërmjet kontit të Korçulës dhe të gjendej mundësia për të ftuar në një vizitë në Venedik, Mark Gjini po të kthehej nga Roma, apo nëse Tomë Plezha do të dilte në Budue të zbatohet urdhri i arrestimit.¹²

Për të shpejtuar nisjen e ushtarëve nga Roma, peshkopi kishte nisur Mark Gjnin për të asistuar në transportimin e ushtarëve nga Brindisi për në Shqipëri. Informatori nuk kishte guxim dhe kishte shtyrë sulmin mbi Ulqinin derisa të shkonte në Kotorr, pastaj e informoj provedidorin e Kotorrit.¹³ Venediku përkrahte kryengritjet çlirimtare në Shqipëri, vetëm

Mbi çështjen e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI-XVII..., 110.

¹⁰ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. II (1593-1602) dok. (39): "1595 tetor 14, Venediku-Senati porositi provedidorin e Kotorrit t'i japë të gjithë ndihmën e duhur proveditorit të flotës ku mund të arrestojë krerët shqiptarë, që bëjnë marrëveshje për kryengritjen e armatosura", 65.

¹¹ *Po aty*, dok. (40): "1595 tetor 18, Venediku - i përsëritet porosia rektorit proveditorit të Kotorrit për çështjen e arrestimit të krerëve shqiptarë etj. E lavdërojnë për informatat që ka dërguar dhe porositi të bindë informatorin që të vazhdojë t'ua mbushë mendjen krerëve shqiptarë që ta shtynë për një kohë tjetër kryengritjen e armatosur", 66.

¹² *Po aty*, dok. (42): "1595 dhjetor 2, Venedik i jep porosi qeveritarit të Kotorrit se si duhej vepruar për arrestimin e peshkopit të Kurcolës, të Tomë Plezhës e Mark Gjnit dhe për përgjigjen që u duhet dhënë kërkesave të shqiptarëve", 69-70; Thëngjilli, Petrika, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit (1506-1750)*, 122.

¹³ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. II (1593-1602) dok. (34): "1595 tetor 9, Kotorr - Procesverbali për një njeri që merret në pyetje në lidhje me bisedimet e marrëveshjes që janë duke u bërë për organizimin e kryengritjes në Shqipëri", f. 50-51; Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*, 120.

atëherë kur i përshtatej interesave të tyre. Në rast të kundër ajo jo vetëm që nuk i mbështeste, por edhe i pengonte ato. Prandaj, bëri përpjekje maksimale të dështojnë projektet e nxjerra nga Kuvendi i Matit dhe t'u prezantohen shteteve të Evropës. Për këtë u përpoq që mos të lejonte delegacionin e krerëve shqiptarë të shkonin në Romë, dhe nga ana tjetër u mundua të bënte intriga ndaj krerëve shqiptarë që punonin për çlirimin e vendit të tyre.

Në fillim të vitit 1596 kapedan Mark Gjini, i shkruan Papës: *tetorin e kaluar, unë kapedan Mark Gjini u duka të këmbët e Shkëlqesisë Tuaj, si i dërguar nga kombi im shqiptar, duke ju lutur që të urdhërosh dhënien e ndihmës prej 1 000 këmbësorëve, më pagë e armë, për me u mundu me e marrë Ulqinin, Shkodrën dhe Krujën, fortesa në Shqipëri, për të ngritur në këmbët e gjithë kombin të bindur ndaj Shkëlqesisë Tuaj, për ta larguar njëherë e përgjithmonë nga mizoritë e ushtrisë osmane që bënin në trevat shqiptare. E përgjegjshme aso kohë për shpenzimet e mëdha që po bënte ushtria Juaj në Hungari, nuk mujshi me lenë këtë tjetrën ekspeditën time, por se shpejti kishin për të na ngushëllua. Pasi që nuk janë me ato shpenzime, dhe mbasi është kjo vjeta më të cilën të deleguarit e turqve do të vinin si zakonisht për të marrë 10 ose 12 mijë fëmijë për t'i konvertuar në turq, të cilët kanë mbet të janë të pambrojtur. Shkëlqesia e Juaj, si Klemërit (dhimbshëm), e si baba i përbashkët i krishterimit të keni dhimbje për kaq shpirtra që kanë me humbur. E të dënoheni me më dhënë për ekspeditën time nëse jo 1 000 këmbësorët e kërkuar, bile së paku 500 skudë, ose armatim për me iu shpërnda popullit tim që nuk kanë armë. Përveç ushtarëve këmbësorë, kërkoj edhe kolonelë dhe gjeneralë me pushtet që të mund të krijojnë kufijtë qeveritarë, dhe me ndëshkua mizoritë që shkaktojnë dëme në vendin tonë. I premtoj Shkëlqesisë Tuaj, unë me parinë e kombit tim se do marrim obligime me i krye punët e sipërthëna me të cilat jo vetëm kemi me i lirua fëmijët nga rreziku që mund t'u vihej, por, edhe kemi me u çlirua nga zgjedha osmane. Do bëjmë rezistencë të madhe kundër pushtuesve osmanë dhe do bëjnë përparime të mëdha në çlirimin përfundimtar të vendit. Dhe në shembullin tonë, padyshim do të na mbështesin edhe vendet tjera të Ballkanit, të cilëve Shenjtëria Gregori XII i vdekur u kishte dhënë armë. E me kaq pak shpenzime Shkëlqesia Juaj, do t'i bojë një shërbim shumë të mirë. Për këtë ndihmë i lutëm Shkëlqesisë Tuaj në emër të të gjithë kombit tim, duke marrë në radhë të parë shërbimin e Zotit dhe lumturinë e Shkëlqesisë Tuaj se çdo rrezik që më vjen nga dëbimi shumë i rëndë që më dhënë mua dhe Zotit Kavaljer Pelessit, duke na i hequr rrogat dhe duke vendosur një taksë për kokë edhe në ato koka që nuk janë*

*të Zotonit venecianëve. Ne kemi ardhur të kombet tuaja, me besën dhe shpresën që na ishte premtuar herën tjetër, jam kthye përsëri me Ju lutë për ndihmat e sipërthëna.*¹⁴

Më 13 maj të vitit 1606, në emër të popullsisë së krishterë të mbretërisë së Maqedonisë, të Shqipërisë, të Serbisë dhe të Dukatit (Hercegovinës), ishin prezantuar tek Papa Pali V, Mark Gjini, Anton Nikolla kapiten shqiptar, konti i Podgoricës Anton Nikolla (Kolajani). E përshkruan gjendjen tejet të rëndë nëpër të cilën po kalonin popujt e Ballkanit nga represioni i ushtrisë osmane, dhe kërkonin ndihmë për fillimin e një aksionin të përbashkët në Ballkan në kuadër të përpjekjeve të tyre çlirimtare. Pas dy orësh bisedime, me kërkesën e tyre Papa i drejtoi për te mbreti i Spanjës, ku kërkuan ndihmë për mbrojtjen e popullsisë së krishterë në këto treva.¹⁵

Më 21 mars 1607, në letrën e proveditorit venedikas të Kotorrit, Tomazo Kontarini, drejtuar Senatit të Venedikut, ai tregon emrat e krerëve shqiptarë dhe të tjerë që gjatë kësaj kohe kanë lidhur marrëveshje me spanjollët.¹⁶ Lista e emrave të besëlidhurve shqiptarë dhe të tjerë, që kanë bërë marrëveshje me spanjollë. Simeon Pinjатели, konsull i Spanjës; Gardan Vojvoda nga Nikshiçi; Dom Leka në Shestani, rrethi i Shkodrës; Mark Gjini, vëllai i guvernatorit Pal; Dom Theodor i futur në këtë çështje së voni; Niko Bratovi nga Zupe, i vdekur në burg në Napoli; Dhimitri, konti i Shestanit; Gjini Gjergji,¹⁷ kont shumë i rëndësishëm në Shqipëri; Rado i Nikollës,¹⁸ galeot sekse nga, Ragusa.¹⁹

Mark Gjini, së bashku me Anton Nikollën pas kthimit nga Spanja diskutuan përsëri planet me nënmbretin e Napolit. Në Madrid i bënë me dije

¹⁴ AQSH, fondi, 846, dosja 65; Kapedan Mark Gjini në fillim të vitit 1596 i shkruan Papës, për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve për çlirimin nga Perandoria Osmane.

¹⁵ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. III (1603-1621), Përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1989, dok. (14): "1606 maj 13 - Papa Pali V, me një letër porosie, përcjellë dhe i paraqet mbretit të Spanjës kapedanin shqiptar, Mark Gjini, dhe kontin e Podgoricës, Anton Nikollën, të cilët janë përfaqësuesit e popullsisë kryengritëse të Ballkanit, që t'u jepet ndihmë lëvizjeve çlirimtare në Shqipëri dhe në vendet e tjera", 55.

¹⁶ Јован Н. Томић, *Грађа за историју покрета на Балкану против Турака крајем XVI и почетком XVII века*, Српска краљевска академија, 1933, dok. CCXLV (292),. 421.

¹⁷ Gjini Gjergji ishte treguar i gatshëm ta marrë Shkodrën me bashkëpunimin e fshatarëve.

¹⁸ Për këtë njeri thuhet «galeottosensale», fjala sassaro e kishte kuptimin gurgdhendës (nga sasso-gurë).

¹⁹ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëll. III (1603-1621), dok. (65): "1607 mars - Kopje e listës së besëlidhurve shqiptarë e të tjerë, që bëjnë marrëveshje me spanjollët", 136.

mbretit për gjendjen e rëndë dhe për vuajtjet e të krishterëve në provincën osmane të gadishullit ballkanik.

Popujt e krishterë të Ballkanit kishin varur shpresat në ndihmën e mbretërve perëndimorë. Pushtimi i krahinave ballkanike nuk do të ishte i vështirë për t'u realizuar, dhe me kosto jo të madhe. Vetëm në krahinat shqiptare kishte rreth 3 000 fshatra të banuara me popullsi krishtere, si dhe për çdo fshat do të mblidheshin nga 20 njerëz, dhe brenda një kohe të shkurtër do të mblidhen një ushtri rreth 60 000 vetash. Për t'i quar përpara projektet çlirimtare ishin lidhur edhe me disa shqiptarë të islamizuar, të cilët do të ndihmonin për pushtimin e Shkodrës, Krujës dhe Ulqinit. Pastaj behët fjalë për ndihmën që do t'u ofrohej nga Spanja për të filluar ndërmarrjen luftarake, 2 000 këmbësorë spanjollë, 300 shqiptarë nga Pulja, 2 000 mosketa dhe arkebuza, ku flota spanjolle duhej të qëndronte pranë Brindisit ose Tarantos, dhe pasi të merrte lajmin për kryerjen me sukses të aksioneve luftarake, të nisej në drejtim të Shëngjinit, dhe pastaj tërë vendi do të kalonte nën anën e spanjollëve. Fillimin e operacione e kishin parashikuar në shtator, sepse në këtë stinë kishte ushqime të mjaftueshme. Arsye tjetër ishte se në atë kohë ushtria osman do ishte angazhuar në betejat që zhvilloheshin në Hungari dhe Persi.²⁰ Të dërguarit u pritën mirë në oborrin spanjoll, ku në parim u akorduan me projektin e tyre për pushtimin e qyteteve të rëndësishme në Shqipëri. Duka i Lermës dhe Nunci papnor thoshte: «se kjo ndërmarrje pëlqehet dhe është e realizueshme, e për këtë do jep armë e njerëz²¹». Por, sikur edhe më parë, tashmë kardinali, sekretari i Shtetit nuk ishte i bindur në suksesin e ndërmarrjes, dhe e shikonte të hershëm një misionin të tillë.

Kur në pranverë të vitit 1607, Mark Gjini, Domenik Andreasi dhe Atë Domiani shkuan në Spanjë dhe i dërguan mbretit spanjoll një letër të Nikollë Mekajshit, ku ndër të tjerat thuhej «i premtonte Shqipërinë, me pëlqimin e tij».²² Më 15 maj 1607, ambasadori Venecian në Napoli e cilësonin «ipeshkvin e Stefanisë» si mbështetësin kryesor të spanjollëve në Shqipëri. Në shtator të vitit 1608, agjenti venecian, Françesko Skorroveo, njoftonte nga Budua, se ipeshkvi i Stefanisë kishte biseduar në vazhdimisht me dalmatinin, Dolishti, në Rodon, për mundësinë e shpërthimit të një kryengritjeje shqiptare, dhe për vendosjen e sundimit spanjoll: «i kishin

²⁰ Bartl, *Ballkani Perëndimor*, 146.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, 118.

thënë kalorës Dolishtit, që t'ia transmetonte mbretit të Spanjës se ata ishin besnikë vetëm të spanjollëve».²³

Më 24 maj të vitit 1607, në letrën e përfaqësuesit venedikas në Napoli, Agostino Dolce,²⁴ drejtuar Senatit të Venedikut, shpjegon përpjekjet që po bëjnë kalorësi Dolisti, Mark Gjini dhe bashkëpunëtorë të tjerë. Me projektet e tyre bënin përpjekje për të konkretizuar planet e zbarkimit të spanjollëve në Lezhë, duke synuar marrjen e Shkodrës dhe vendet tjera përreth. Për këtë çështje marrëveshja ishte lidhur më kërër me të fuqishëm të Shqipërisë. Kalorësi Dolisti, me të cilin kishte biseduar madhëria e tij katolike (mbreti i Spanjës), bëri përpjekje që brenda një kohe të shkurtër Shqipëria të bjerë nën pushtetin e saj, dhe të gjitha planet dhe përpjekjet do behën fshehurazi. I lartpërmenduri Dolisti, një muaj më përpara shkoi me galeonin²⁵ e vet në Shqipëri dhe që andej shkoi në drejtim të Redonit, me pretekst se do të ngarkonte grurë. Por, ideja ishte të shikonte dhe të studionte terrenin, madje ai i fali autoriteteve osmane që kontrollonin atë pjesë të bregdetit, disa skllëvër që ishin kapur në Durrës prej galerëve të Napolit.²⁶ Ideja e dorëzimit të skllëvërve autoriteteve osmane, kishte të bënte më marrjen e sa më shumë informacioneve për ato pjesë bregdetare dhe në njëfarë mënyre të sigurohej për veprimet e tij të ardhshme.

Në këtë rast Dolisti, ishte në marrëdhënie me disa kallogjerë të Pejës, të cilët të gjithë kanë marrëdhënie me Patrikanën e Pejës, me farefisnin dhe me shumë bejlerë e sanxhakbejlerë. Patrikana e nxiti akoma me shumë zëvendësmbretin, që kur të mundet ta dërgojë flotën katolike me forca të

²³ *Po aty*.

²⁴ Familja e Augustino Dolce me origjinë veneciane dhe ishte mjaft e pasur, me pasuri të patundshme në qytet. Duke përdorur shtetësinë e tij origjinale, Dolce filloi karrierën në Sekretarit në Administratën e Shtetit midis radhëve të burokracisë së lartë veneciane. Më 1588 ai u emërua sekretar i zakonshëm dhe shumë shpejt u përdor në misione në ushtri, si në Francë dhe Kostandinopojë. Ai u emëruar sekretar i Senatit në vitin 1605, Dolce pas një qëndrimi të shkurtër në Palmanova tek administratori Andrea Gussoni, u dërgua në vitin 1606 në Napoli dhe qëndroi atje deri në nëntor të 1609. Dolce nga Napoli filloi veprimtarinë diplomatike që synonte informimin e mëkëmbësit dhe shoqëruesit të tij mbi arsyet e Venecias dhe në të njëjtën kohë synonte të pasqyronte gjendjet shpirtërore të sundimtarëve spanjollë dhe napolitanë për përplasjen aktuale. Ai raportoi për lëvizjeve dhe përpjekjet që bënin shqiptarët kundër pushtuesve osmanë, dhe për mundësinë e zbarkimit të spanjollëve në trevat shqiptare.

²⁵ Galeon quhej anija me vela të mëdha, me shumë stade të përdorura për herë të parë si transportues e mallrave nga shtetet evropiane nga shek. XVI. Me këtë lloj anije transportoheshin njësitë kryesore të flotës ushtarake. Anije të tilla ishin shtylla kryesore e tregtisë detare, dhe shpesh hartoheshin në përdorim si anije ndihmëse të luftës detare.

²⁶ *AQSH*, fondi, 846, dosja 77, Letër e përfaqësuesit venedikas në Napoli, Agostino Dolce, drejtuar Senatit të Venedikut, 152; Томић, *Грџа за учопуј*, dok. CCLVI (314), 454.

shumta ushtarake në trevat e lartpërmendura. Të gjitha përpjekjet bëheshin për ta marrë Shkodrën nga mbreti i Spanjës, duke ndjekur strategjinë në vijim: këta vazhdimisht bëni përpjekje që përmes të hollave të bënin për vete titullarin e dizdarit të Shkodrës, i cili kishte nën urdhërat e tij komandën e trupave mbrojtëse të fortesave. Sapo të dorëzohej fortës, shumica e të krishterëve dhe në marrëveshje me të tjerët, do të arrinin të bënin përparime shumë të mëdha kundër ushtrisë osmane. Sepse Shkodra është kyçi i gjithë ndërmarrjes së tyre, ndërsa fortesat tjera nuk mund të pengojnë rrugëtimin tonë. Për të mundësuar realizimin e një ndërmarrje të tillë, përmes të hollave kanë bërë marrëveshje tjetër me Andrea Manase dhe Pailila, që të dy shqiptarë nga Qullëzi, fshat ndërmjet Shkodrës dhe Lezhës, të cilët janë treguar të gatshëm, sepse kanë shumë njerëz pas vetës, që e mbrojnë anën e katolikëve (mbretit të Spanjës). Ata kërkojnë që të blihet zyra e thënë e dizdarit nga një besnik i tyre dhe pastaj nga ana e detit në të njëjtën kohë të hynë edhe spanjollët me forca të mëdha.²⁷ Për të realizuar këtë ndërmarrje planesh, kur Dolisti u kthye prej Rodonit, solli me vete dy vetë që të dy nga Perasto, që kishin mision sekret të cilin u ka ngarkuar Dolisti, për të dërguar të holla në Raguzë. Këto lëvizje njerëzish dhe veprime tjera të ngjashme u bënë në emër të zëvendësmbretit, përveç atyre të Dolistit nga bindja dhe kërkesat këmbëngulëse që bënte Mark Gjini. Pasi spanjollët të marrin Lezhën, Mark Gjini insistonte se si skele të Shqipërisë të merret fortës e Shkodrës dhe pastaj lehtësisht në këtë mënyrë të merrej e gjithë Shqipëria. Ai kishte kontakte të shpeshta me Shkëlqesinë e Tij dhe me sekretarin Tores, jo vetëm ditën edhe natën duke biseduar gjerë e gjatë për planet dhe veprimet e mundshme. Përveç Mark Gjinit, marrëdhënie të ngushta spanjollët kishin edhe me Matheu Grego dhe Vincent Biskeja, emër i njohur nga shumë për autoritetet e Venedikut. Këta të dy së bashku edhe më Pjetër Lancën, një vit më përpara ishin akorduar me shkëlqesinë e tij që të kryenin ndërmarrjen e Lezhës, siç u kishte mbushur mendjen Mark Gjini.²⁸

Edhe pse projektet dhe kuvendet shqiptare nuk gjetën mbështetje e duhur nga shtetet e Evropës Perëndimore, ballkanasit nuk i ndalen përpjekjet e tyre pranë kancelarive evropiane për t'i realizuar përpjekjet e tyre për çlirimin e Ballkanit. Në fillim të shek. XVII shqiptarët ngritën zërin kundër atyre krerëve që me intrigat dhe ambiciet e tyre i dëmtonin shumë lëvizjet çlirimtare në Ballkan. Luftën e popujve të Ballkani, për ta çuar

²⁷AQSH, fondi, 846, dosja 77, Letër e përfaqësuesit venedikas në Napoli, Agostino Dolce, drejtuar Senatit të Venedikut, f. 152.

²⁸Po aty.

përpara ishte angazhuar edhe Austria së bashku me Spanjën, ku kishin ndarë edhe sferat e interesave të tyre, por hasnin në pengesa që vinin nga Venediku. Spanja bëri përpjekje të shtrijë ndikimin e saj në Shqipëri, në anën tjetër Austria u mundua të vepronte në Dalmaci.

Mark Gjini deri në vitin 1607 ishte shumë aktiv me projektet e tij, jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe pranë shteteve evropiane. Ai ishte njëri më personalitet të lartë, i cili punoi fuqishëm për çlirimin e Shqipërisë nga sunduesit osmanë. Është e panjohur jeta dhe veprimtaria e tij nga viti 1607 e tutje. Duke pasur parasysh tërë veprimtarinë e tij kombëtare. Ai gjatë tërë kohës ishte në vëzhgimin e agjentëve të Perandorisë Osmane. Mendoj që shumë arsye e kanë detyruar të tërhiqej nga veprimtaria e tij.

Luan TETAJ

SUMMARY

MARK GJINI PROJECTS FOR THE LIBERATION OF ALBANIA (1596-1607)

This paper generally deals with the figure and personality of Mark Gjini. He was one of the most deserving personalities in the struggle of Albanians against the Ottoman invaders, in the last decade of the century. XVI and at the beginning of the century. XVII. During that time it was very difficult to organize in armed uprisings, because the economic situation of the Albanian territories and beyond was very difficult, they had no money to buy weapons and other things to trigger the war. But, Mark Gjini, did not stop his efforts, addressed the chancelleries of European countries to support him materially and militarily to support the just struggle for the liberation of Albanian lands against the Ottoman rulers.

On October 13, 1595, Mark Gjini had gone to Rome, who presented the project for the liberation of Albanian territories, to Cardinal P. Aldobrandi. At the beginning of 1596, Captain Mark Gjini wrote to the Pope, asking him to help materially and militarily the efforts of the Albanians for liberation. In the spring of 1607, Mark Gjini, had gone to Spain and sent a letter to the Spanish king from Nikolle Mekajshi, hoping for his support. From 1607 onwards we have no data on how the figure and activity of the Albanian captain Mark Gjini ended.